

# Ora e Kodit

## Udhëzues i pjesmarrjes

Cdokush mund të mësoj  
11-15 Dhjetor, 2022

# ORA E KODIT

**Ora e Kodit** është një event global i cili ka për qëllim njoftimin e miliona nxënësve në mbarë botën me shkencat kompjuterike, duke i inspiruar fëmijët që të mësojnë më shumë, të thejnë stereotipe dhe të ndihen të inspiruar për të vazhduar tutje! Ndhimmo nxënësit të provojnë orën e tyre të parë të kodit duke ndjekur këta hapa:

Ora e kodit është e lehtë për t'u mbajtur - edhe për fillestarët. Filloni sot!

## 1 Zgjedhni aktivitetin tuaj për Orën e Kodit


Ka aktivitete zbatimëse për nxënës të të gjitha moshave, të krijuara nga shumë partnere për një gamë të gjërë lëndësh mësimore. Dëshironi të zhvilloni një Orë Kodi në lëndën e gjuhës angleze ose të historisë? Kemi shumë opsionë për këtë!

### Opsione të ndryshme nga të cilat mund të mësoni:

**I vetëdrejtuar** - kërkon përgaditje minimale nga mësuesit.

**I drejtuar nga mësuesi/ja** - plane mësimore për cdo mësues.

Aktivitetet e Code.org përfshijnë Minecraft, Star Wars, Frozen, Angry Birds, dhe shumë aktivitete të tjera!



## 2 Regjistrojeni klasën tuaj dhe rekrutoni shkollën tuaj!

### Mësuesit

Mbani një Orë Kodi për të gjithë nxënësit përgjatë javës. Inkurajoni edhe mësuesit e tjerë që të bëjnë të njejtën gjë.

### Drejtoret

Planifikoni që të gjithë nxënësit tuaj të marrin pjesë në një Orë Kodi. Nuk ju duhet kompjuter për cdo nxënësi.

### Inspektorët

Sfidoni cdo shkollë në komunën tuaj që të regjistrohet!

### Prindërit

Përcjelleni këtë guide tek shkolla juaj. Regjistrohuni si vullnetarë që të mund të ndihmoni.

## 3 Planifikoni nevojat tuaja teknologjike - kompjuterët janë opsional

Ora e Kodit ekzekutohet më së miri me kompjuter që janë të lidhur me internet. Nuk ka nevojë për regjistrime ose shkarkime, poashtu nuk keni nevojë për kompjuter për secilin nxënësi.

### Në laboratorin e shkencave kompjuterike?

Sjellni klasën tuaj në laboratorin e shkencave kompjuterike në mënyrë që të fillojnë me mbajtjen e Orës së Kodit.

### Në klasë

Nxënësit mund të shkojnë me rradhe dhe të përdorin kompjuterin e lidhur me internet ose tabletën për të kompletuar një Orë Kodi.

### Punoni në grupe

Inkurajoni nxënësit që të formojnë grupe dhe të përdorin një kompjuter. Ose të gjithë nxënësit mund të bëjnë një Orë Kodi së bashku në projektor.

### Inkurajoni prindërit që të sjellin pajisje harduerike

Nëse shkolla juaj është e pajisur me wifi, pyetni prindërit nëse mund të sjellin tableta ose laptop në mënyrë që t'i përdor klasa juaj.

### Përdorni pajisje mobile

Nëse shkolla juaj nuk ka kompjuterë të mjaftueshëm, shumica e aktiviteteve mund të bëhen edhe përmes pajisjeve mobile ose tabletave.

### Shkyquni!

Ne ofrojmë aktivitete offline të cilat kanë të bëjnë me konceptet bazike të shkencave kompjuterike - nuk ka nevojë për pajisje elektronike.



4

## Shpërndani fjalën tek nxënësit dhe prindërit

### Shpërndani materiale promovuese

Inspiro nxënësit përmes videove dhe posterave. Gjeni gjithçka që ju duhet tek [hourofcode.com/promote](https://hourofcode.com/promote)

### Inkurajoni prindërit që të marrin pjesë poashtu!

Nxënësit më prinder të cilët janë të përfshirë në këtë proces kanë më shumë prirje që të studiojnë shkencat kompjuterike. Shihni një email shembull që mund t'i dërgohet prindërve tek [hourofcode.com/promote/resources](https://hourofcode.com/promote/resources).

### Mbani një Ore Kodi për prindërit

Në mënyrë që prindërit të jenë sa më të përfshirë në procesin e kodimit, ftoni ata që të mbajnë një Ore Kodi me fëmijët e tyre dhe mësuesit nga shkolla e tyre.

### Shpërbleni pjesëmarrësit

Krijoni qmime dhe dhurata për mësuesit dhe nxënësit.

5

## Festo Oren tënde të Kodit

### Mbaj një mbledhje me të gjithë shkollën

Trego një video nga Code.org ose fto një folës për të bërë një aktivitet të shkyqur me nxënësit përpara të gjithë shkollës.

### Kontakto mediat dhe zyrtarët lokal

Trego atyre për pjesëmarrjen e shkollës tënde në lëvizjen internacionale të Orës së Kodit.

### Fto komunitetin

Familjet, vullnetarët, dhe liderët e bizneseve mund të mësojnë poashtu. Përdor Orën e Kodit për të rekrutuar nxënës për kurse të shkencave kompjuterike në shkollë të mesme.

### Festo

Ndaje eksperiencën tënde përmes fotove duke i postuar ato në rrjete sociale me hashtagun #OraeKodit

6

## Vazhdo të mësosh - shko përtej Orës së Kodit!

### Vazhdo të mësosh në klasë ose online

Vazhdo me platformen e mësimin online të Code.org, ku mund të shohësh progresin e bërë nga cdo nxënës përderisa ata mësojnë në mënyrën e tyre, gjej burimet më të mira për klasën tuaj tek [code.org/educate](https://code.org/educate).

### Zgjero shkencat kompjuterike në shkollën ose komunën tënde

Zgjero shkencat kompjuterike në shkollën ose komunën tënde - Vizito [code.org/yourschool](https://code.org/yourschool) të mësosh më shumë se si mund të sjellësh një nivel të ri të shkencave kompjuterike dhe zhvillimit profesional në shkollën tënde. Inkurajo mësuesit e shkollës fillore të gjejnë punëtori falas në [code.org/k5](https://code.org/k5).

### Ndihmo në heqjen e politikave penguese në shkencat kompjuterike

Code.org dhe partneret janë duke punuar rreth ndryshimit të politikave në nivelin federal, shtetror dhe atë lokal në mënyrë që të rrisin qasjen në shkencat kompjuterike për të gjithë nxënësit. Mëso se çfarë po ndodhë në rrethinën tënde dhe se si mund të ndihmosh në [advocacy.code.org](https://advocacy.code.org)



"I sfidoj vajzat në cdo shtet që të mësojnë një Ore Kodimi"

**Malala Yousafzai**

Fituesja e Qmimit Nobel për paqe

**Bashkoju lëvizjes  
5-11 Dhjetor, 2022!**

**Fillo tek [hourofcode.com](https://hourofcode.com)**

Ora e Kodit është e organizuar nga Code.org, një organizatë publike jo-qeveritare e dedikuar rreth zgjerimit të qasjes në shkencat kompjuterike në shkolla dhe drejt rritjes së pjesëmarrjes nga vajzat e reja dhe nga grupet e nënpërfaqësuar. Ora e Kodit mbahet gjatë Javës së Edukimit në Shkencat Kompjuterike gjatë Dhjetorit. Code.org, logoja e Code dhe Ora e Kodit janë marka të regjistruara të Code.org.